



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:168084

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05674698

**C.nr.795/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Saranda Aliaj, në çështjen juridike civile të paditësve: R. Q nga fsh.D ,B. Sh nga S, V.Z nga fsh.B, I. M nga fsh.S, Dh. K nga S ,A. K nga K e P, A. E nga S, L. B nga Sh , F. M nga Sh , T. E nga S, S. B nga S, M. H nga fsh.P, M. R nga Sh, N. B nga fsh.S, N. K nga fsh.B ,F. K nga fsh.Q, A. S nga S, J. K nga fsh.K e E, K. K nga fsh.S, L. G fsh.K e E, M. B nga fsh.B, G. Q nga fsh.G, J. Z nga S, K. Q nga fsh.G, M. F nga fsh.P, E. K nga fsh.B, Z. S nga fsh.B, V. Z nga fsh.S, të cilët me autorizimit i përfaqëson Av.Z . B .B nga F, ndaj të paditurës K e S, D . K e A, me objekt kontesti për pagesen e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, me datë 13.05.2024, bie këtë:

### **A K T G J Y K I M** **Pa shqyrtim kryesor**

**I.APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësve :R.Q,B.SH, V.Z, I.M, DH.K, A.K, A.E, L B, F.M,T.E, S.B, M.H, M.R, N.B-B, N.K, F.K, A.S, J.K, K.K, L.G, M.B, G.Q, J.Z, K.Q, M.F, E.K, Z.S, R.Q,B.SH, V.Z, I.M, DH.K, A.K, A.E, L B, F.M,T.E, S.B, M.H, M.R, N.B-B, N.K, F.K, A.S, J.K, K.K, L.G, M.B, G.Q, J.Z, K.Q, M.F, E.K, Z.S, dhe V.Z.

**II.DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësve në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për periudhën 01.04.2019 deri me 21.11.2022 t’ia paguaj shumat si në vijim:

**Paditësit R. Q, në emër të shpenzimeve të ushqimit gjithësejt për 593 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për**

**230 ditë**,shuma prej **460 euro**,kurse per periudhën **01.01.2020 - 15.07.2021** per **363 ditë** shumën prej **726 euro**.Gjithësejt shumën e përgjithshme prej **1,186 euro**.

**Paditësit B. Sh**,në emër të shpenzimeve të udhëtimit për **149 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 - 21.12.2019** në relacionin Suharekë –Duhël me cmim të biletës prej **2 euro** në dy drejtimet shumën prej **208.60 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **208 ditë** primare në punë shumën prej **291.20 euro**,gjithësejt për **357 ditë** shumën e përgjithshme prej,**499.80 euro**.

**Paditësit V. Z**,në emër të shpenzimeve të udhëtimit për **344 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** në relacionin Bllacë – Duhël dhe anasjelltas për **166 ditë** me cmim të biletës prej **1 euro** shumën prej **116.20 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **178 ditë** në relacionin e sipërshenuar shumën prej **124.60 euro**.

**Paditësit I. M**, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për relacionin Samadraxhe - Suharekë- Duhël me cmim të biletës prej **2 euro** për periudhën **01.01.2019- 31.12.2019** për **168 ditë** shumën prej **352.80 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **288 ditë** shumën prej **604.80 euro**.

**Paditëses Dh. K** , në emër të shpenzimeve të udhëtimit për **454 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 - 31.12.2019** për **168 ditë** në relacionin Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro** duke e llogaritur në **70 %** e biletës së trafikut urban shumën prej **232.40 euro** kurse për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **286 ditë** në relacionin e sipërshenuar shumën prej **400.40 euro**,gjithësejt shumën e përgjithshme prej **632.80 euro**.

**Paditësit A. K**, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për **244 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2010-15.07.2021** për **168 ditë** primare në punë në relacionin Krushicë e Epërme- Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **3 euro**,duke e llogaritur në **70%** e trafikut urban shumën prej **512.40 euro**.

**Paditëses A. E**, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për **456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019-31.12.2019** për **168 ditë** primare në punë në relacionin Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro**,duke e llogaritur në **70 %** e trafikut urban prej **235.30 euro** për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **288 ditë**

primare në punë në relacionin e lartëcekur si dhe cmimin e lartëcekur në shumën prej **403.20 euro**. Gjithësejt shumën e përgjithshme prej **638.40 euro**.

**Paditëses L. B, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019-31.12.2019** për **168 ditë** në relacionin Sh– S – D, dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro**, shumën prej **235.20 euro**, dhe për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **288 ditë** shumën prej **403.20 euro** duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban, gjithësejt shumën e përgjithsme prej **638.40 euro**.

**Paditësit F. M, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 349 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019-31.12.2019** për **168 ditë** në relacionin Suharekë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro** shumën prej **204.40 euro**, dhe për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **203 ditë** pune shumën prej **284.20 euro** ,duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban, gjithësejt **488,60 euro**.

**Paditëses T. E, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019-31.12.2019** për **168 ditë** pune në relacionin Suharekë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **1 euro** duke e llogaritur në 70% të biletës së trafikut urban shumën prej **117.60 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **228 ditë** në relacionin dhe cmimin e lartëcekur shumën prej **201.60 euro**, gjithësejt shumën e përgjithshme **319.20 euro**.

**Paditëses S. B, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 - 31.12.2019** dhe atë për **168 ditë** në realacionin Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **1 euro** duke llogaritur në 70 % e biletës së trafikut urban shumën prej **117.60 euro**, si dhe për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **288 ditë** në relacionin dhe cmimin e lartëcekur shumën prej **201.60 euro**, gjithësejt shumën e përgjithsme **319.20 euro**.

**Paditësit M. H, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë në relacionin Peqan-Suharekë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro** për periudhën **01.01.2019-31.12.2019** shumën prej **235.20 euro** duke e llogaritur në 70% të biletës së trafikut urban, kurse për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **288 ditë** pune në relacionin dhe cmimin e lartëcekur shumën prej **403.20 euro**.

**Paditësit M. R, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 357 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 për 149 ditë primare në punë në relacionin Shtime-Duhel dhe anasjelltas me cmim të biletës prej 3 euro, shumën prej 312.90 euro, kurse për periudhën 01.01.2020-15.07.2021 për 208 ditë primare në punë shumën prej 436.80 euro, gjithësejt shumën e përgjithshme prej 749.70 euro.**

**Paditëses N. B –B, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 për 168 ditë në relacionin Gjinoc-Suharekë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej 3 euro duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumën prej 352.80 euro, kurse për periudhën 01.01.2020-15.07.2021 në relacionin e lartëcekur dhe cmimin e lartëcekur për 288 ditë primare në punë shumën prej 604.80 euro.**

**Paditësit N. K, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 455 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për 167 ditë primare në punë në relacionin Bllacë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej 1 euro, shumën prej 113.40 euro, dhe periudhën prej 01.01.2020-15.07.2021 për 288 ditë primare në punë në relacionin dhe cmimin e lartëcekur shumën prej 201.60 euro, gjithësejt shumën e përgjithshme prej 315 euro.**

**Paditësit F. K, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 594 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për 230 ditë në relacionin Qadrak – Suharekë – Duhël dhe anasjelltas, me cmim të biletës prej 2 euro, duke e llogaritur në 70% të biletës së trafikut urban shumën prej 322 euro, kurse për periudhën 01.01.2020-15.07.2021 për 364 ditë primare në punë në relacionin dhe cmimin e lartëcekur shumën prej 509.60 euro , gjithësejt shumën e përgjithshme prej 831.60 euro.**

**Paditësit A. S, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 357 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për 149 ditë shumën prej 208.60 euro, kurse për periudhën 01.01.2020 – 15.07.2021 për 208 ditë shumën prej 291.20 euro, në relacionin Suharekë -Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej 2 euro duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban, gjithësejt shumën e përgjithshme prej 499.80 euro.**

**Paditësit J. K, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 388 ditë primare në punë për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019 për 185 ditë në relacionin Krushicë e Epërme - Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me**

cmim të biletës prej **3.60 euro** duke e llogariutr ne 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **466.20 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **203** ditë shumë prej **511.56 euro** ,gjithësejt shumë e përgjithshme prej **977.76 euro**.

**Paditësit K. K, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2020- 31.12.2019** për **168 ditë** primare në punë në relacionin Studenqan – Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **3 euro** shumë prej **352.80 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **288 ditë** pune shumë prej **608.80 euro**,gjithësejt shumë e përgjithshme prej **957.60 euro**.

**Paditësit L. G, në emër të shpenzimeve të udhëtimit,për 265 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **105 ditë** në relacionin Krushicë e Epërme – Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **2 euro** duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **147 euro**,ndërsa për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **160 ditë** në relacionin e lartëcekur shumë prej **224 euro**,gjithësejt shumë e përgjithshme prej **371 euro**.

**Paditësit M. B, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 393 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **230 ditë** në relacionin Ballacë-Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **1 euro**,duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **161 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 -15.07.2021** për **363 ditë** në relacionin e lartëcekur shumë prej **254.10 euro**,gjithësejt shumë e përgjithshme prej **415.10 euro**.

**Paditësit G. Q, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 583 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **225 ditë** në relacionin Shtime – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **3 euro** duke e llogariut në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **472.50 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **358 ditë** primare në punë për relacionin e lartëcekur shumë prej **751.80 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej **1.224.30 euro**.

**Paditësit J. Z, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 349 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **146 ditë** primare në punë në relacionin Suharekë – Duhël me cmim të biletës prej **2 euro**,duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **214.40 euro**,kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **288 ditë**

primare në punë në relacionin e lartëcekur shumë prej **284.20 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej **488.60 euro**.

**Paditësit K. Q, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 593 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **230 ditë** në relacionin Greicec – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **3 euro**, duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **483 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **363 ditë** pune në relacionin e sipërshtuar shumë prej **762.30 euro**.

**Paditësit M. F, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 453 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **166 ditë** primare në punë në relacionin Peqan – Suharekë – Duhël me cmim të biletës prej **2 euro**, duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **232.40 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020-15.07.2021** për **287 ditë** primare në punë shumë prej **401.80 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej **634.20 euro**.

**Paditësit E. K, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 456 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019-31.12.2019**, për **168 ditë** në relacionin Bukosh – Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **4 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **288 ditë** primare në punë në relacionin e lartëcekur shumë prej **806.40 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej **1.276.80 euro**.

**Paditësja Z. S, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 457 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **168 ditë** pune në relacionin Bllacë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës prej **1 euro**, duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **117.60 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** për **289 ditë** në relacionin Bllacë – Duhël dhe anasjelltas me cmim prej **1 euro**, duke e llogaritur në 70% e biletës së trafikut urban shumë prej **202.30 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej **319.90 euro**.

**Paditësja V. Z, në emër të shpenzimeve të ushqimit** gjithësejt për **282 ditë** primare në punë për periudhën **01.01.2019 - 31.12.2019** për **102 ditë** nga **2 euro** shumë prej **204 euro**, kurse për periudhën **01.01.2020 – 15.07.2021** nga **2 euro** shumë prej **360 euro**.

Kurse **në emër të shpenzimeve të udhëtimit** për periudhën **01.01.2019 – 31.12.2019** për **102 ditë** pune në relacionin Savrovë – Suharekë – Duhël dhe anasjelltas me cmim të biletës **2 euro**, duke e llogaritur në 70% e trafikut urban shumë prej **214.20 euro**, kurse për periudhën

**01.01.2020-15.07.2021** për **180 ditë** në relacionin e sipërshenuar dhe cmimin e sipërshenuar shumë prej **378 euro**, të gjitha me kamatë prej 8% nga dita e parashtrimit të kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Paditësit: R.Q, B.SH, V.Z, I.M, DH.K, A.K, A.E, L B, F.M, T.E, S.B, M.H, M.R, N.B-B, N.K, F.K, A.S, J.K, K.K, L.G, M.B, G.Q, J.Z, K.Q, M.F, E.K, Z.S, dhe V.Z, N. K, L. G, M. B, G. Q, J. Z, K. Q, M.F, E. K, Z. S, V. Z, përmes të autorizuarit të tyre Av.Z. B –B nga F, kan paditur K e S, -D. K te A, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

Me parashtrësën e datës 27.02.2024 ka precizuar kërkesëpadinë . Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësve, është e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“ Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënie të tij.”*

E drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t'u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

I autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin udhëtimit dhe ushqimit, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi në vërtetim nr. protokolli 314/23 lëshuar nga SH.F.M.U “Sadri Duhla” D, lëshuar me 23.10.2023, certifikata e vendbanimit nr.ser. B90019501 i datës 03.05.2023, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023, vërtetim nr. protokolli 291/23 i lëshuar me dt.13.10.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser B10458072 e datës 16.05.2023, vërtetim i lëshuar nga Agjensioni Turistik “Sharri” i datës 03.05.2023, vërtetim nr. protokolli 332/23 i datës 30.10.2023, certifikata e vendbanimit nr.ser: B10455223 lëshuar me datë 04.05.2023, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Shpejtimit” lëshuar me datë 05.05.2023, vërtetim nr. protokolli 312/23 i datës 23.10.2023, certifikatë vendbanimi nr.ser: B10454039, vërtetimi nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023, vërtetim nr. protokolli 310/23 i datës 23.10.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser: B10155198 e datës 04.05.2023, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Baashkimi Reisen” i datës 02.03.2023, vërtetim nr. protokolli 309/23 i datës 23.10.2023, certifikata e vendbanimit nr.ser: B10454226, i datës 02.05.2023, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bres Tours” i datës 04.05.2023, vërtetim nr. protokolli 308/23 i datës 23.10.2023, certifikatë e



vendbanimit nr.ser:B10454614 i datës 03.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Jeta” i datës 04.05.2023,vëretim nr.protokolli 305/23 i datës 23.10.2023,certifikata e vendbanimit nr.ser:B104554948 i datës 03.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Suka Transa” i datës 04.05.2023,vëretim nr.protokolli 329/23 i datës 30.10.2023,ekstrakti nga regjistri qendror i Gjendjes Civile nr.ser:E27006526 i datës 03.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Jeta” i datës 02.05.2023,vëretim nr.prtokolli 317/23 i datës 23.10.2023 ,certifikata e vendbanimit nr.ser:B10455092 i datës 04.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 03.05.2023,vëretim nr.prtokolli 160/23 i datës 05.03.2023,vëretim nr.prtokolli 48/24 i datës 15.02.2024,certifikata e vendbanimit nr.ser:B10462170,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bllaca Tours” i datës 16.06.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Diana” i datës 16.05.2023,vëretim nr.prtokolli 51/24 i datës 15.02.2024 ,certifikatë e vendbanimit nr.ser: B10457664 i datës 15.05.2023, vëretim nga Agjensioni Turistik “Shpejtimi” i datës 15.05.2023,vëretim nr.prtokolli 52/24 i datës 15.02.2024,ekstrakti nga regjistri i gjendjes civile nr.ser:E27007835 i datës 03.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Shpejtimi” i datës 10.05.2022,vëretim nr.prtokolli 53/24 i datës 15.02.2024,certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10454521,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023,vëretim nr.prtokolli 59/24 i datës 16.02.2024,certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10454900 i datës 03.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Sedolli”, i datës 02.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023,vëretim nr.prtokolli 60/24 i datës 16.02.2024,certifikatën e vendbanimit nr.ser:B10460768,vëretim nga Agjensioni Turistik “Shpejtimi” i datës 16.05.2023,vëretim nr.prtokolli 61/24 i datës 16.04.2024,certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10455085 e datës 04.05.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bllaca Tours” i datës 03.05.2023,vëretim nr.prtokolli 62/24 i datës 16.02.2024,certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10455950,fatura e tatimit në pronë e datës 08.05.2023,vëretim nr.prtokolli 165/23 i datës 10.05.2023,vërteti nr.prtokolli 63/24 i datës 16.02.2024,certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10453776, e datës,27.04.2023,vëretim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen”i datës 02.05,2023,vërteti nr.prtokolli 64.24 i lëshuar me datë 16.04.2024,vëretim nr.prtokolli

65/24 i datës 16.02.2024, certifikata e vendbanimit nr.ser:B10454499, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023, vërtetim nr.protokolli 162/23 i datës 05.05.2023, vërtetim nr.prtokolli 66/24 i datës 16.02.2024, vërtetim nr.prtokolli 162/23 i datës 05.05.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10454860, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Didi-Soni” i datës 03.05.2023, vërtetim nga agjensioni turistik “Bashkimi Reisen” i datës 02.05.2023, vërtetim nr.prtokolli 99/23 i datës 16.02.2024, vërtetim nr.protokolli 292/23 i datës 13.10.2023, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Suka Trans” i datës 16.02.2024, vërtetim nr.protokolli 320/23 i datës 23.10.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10526144, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Poni Tours” i datës 14.02.2024, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 16.02.2024, vërtetim nr.protokolli 313/23 i datës 23.10.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10525876, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Billaca Tours” i datës 16.02.2024, vërtetim nr.protokolli 294/23 i datës 13.10.2023, certifikatë vendbanimi nr.ser:B10457890, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen” i datës 20.02.2024, vërtetim nr.protokolli 331/23 i datës 30.10.2023, certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10525913, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen”, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Shukaj Tours”, vërtetim nr.protokolli 50/24 i datës 15.02.2024, certifikatë e vendbanimit nr.ser:B10525910, vërtetim nga Agjensioni Turistik “Bashkimi Reisen”, vërtetim nr.prtokolli 46/24 i datës 15.02.2024, u vërtetuan ditët e punës së paditësve për kompensimin e udhetimit dhe ushqimit.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësit gjen mbështetje të plotë në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parasheh: *Punonjësve arsimorë (anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.*

*“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është dy euro për të*

*punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare të institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim*

Gjykata vendosi që t'ia falte besimin provave që kanë prezantuar paditësit, konkretisht vërtetimeve të lëshuara nga drejtoritë e shkollave, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë për 5 paditës shumë prej **624 euro**, për parashtrësë mbi precizimin e kërkesëpadisë për 5 paditës shumë prej **624 euro**, të gjitha këto sipas numrit tarifar 6 me vlerën e objektit mbi 10.000 euro të Odës së Avokatëve të Kosovës ,për taksë gjyqësore shumë prej **21 euro**, gjithësejt shumë e përgjithshme prej 1,269 euro, të gjitha këto në afat prej 7 dite nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata aktgjykimin e ka marr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,**  
**C.nr.795/2021 dt. 13.05.2024**

Gjyqtari  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.